VENDIM
Nr. 157, datë 13.3.2019

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË, TË PRONËS ME NR. RENDOR 19, ME EMËRTIMIN "ISH-NDËRMARRJE METALIKE TIRANË (REPARTI I ORËVE)", ZONA KADASTRALE 8220, TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr.7926, datë 20.4.1995, "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", të ndryshuar, të neneve 13 e 15, shkronja "c", të ligjit nr.8743, datë 22.2.2003, "Për pasuritë e paluajtshme shtetërore", të ndryshuar, dhe të neneve 3 e 8/a, të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të pronës me nr. rendor 19, me emërtimin "ish-Ndërmarrje Metalike Tiranë (Reparti i Orëve)", sipas të dhënave të listës së inventarit, që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 5.12.2018, "Për revokimin e transferimit të së drejtës së pronësisë dhe për një ndryshim në vendimin nr. 285, datë 21.5.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për kalimin e disa pronave, në pronësi të Bashkisë Tiranë, të Njësisë Administrative Tiranë"".

2. Shfuqizimin e vendimit nr.1535, datë 26.11.2008, "Për një ndryshim në vendimin nr. 378, datë 12.8.1999, të Këshillit të Ministrave, "Për kalimin e së drejtës së përfaqësuesit të pronarit për disa objekte, pronë publike, organeve të qeverisjes vendore", të ndryshuar, vetëm për objektin "Metalike Tirana (reparti i orëve)", me numër rendor 2.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Bashkia Tiranë dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen e procedurave të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama